



Datë: 16.10.2025
Numër Protokolli: 5843/2025

A.nr.1647/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1647/2025, të datës 01.09.2025, të parashtruar nga ankuesi A.T, kundër organit të punësimit: Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 16.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprobuhet si e bazuar ankesa numër A.nr.1647/2025, e datës 01.09.2025 e parashtruar nga ankuesi A.T.

II. Detyrohet Menaxheri Njesisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ri procedoj kërkesë pranë Thesarit të Kosovës për realizmin e kompensimit material në emër të pagës jubilarë, të njohur sipas Vendimit me numër protokolli 223, të datës 05.06.2025.

III. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës sipas pikën II të dispozitivit, të ekzekutoj kompensimin financiar të njohur më Vendimin më numër protokolli 223, të datës 05.06.2025.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, A.T, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 01.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos të mosekzekutimit të pagës jubilarë në shumën prej 363.00 Euro, sipas Vendimit me numër protokolli 223, të datës 05.06.2025, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 11.09.2025, ka shkresat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5843/2025, të datës 01.09.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli Nr.223, të datës 05.06.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kontratën e punës KI:2008949827; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.09.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 11.09.2025; Akt emërimit AE:Nr.073/2022, të datës 13.10.2022; Shkresën zyrtare të datës 01.09.2025; Kërkesën për realizimin e pagës jubilarë të datës 23.05.2025.

Kolegji i Këshillit pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur së ankesa e ankuesit është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovë dhe se i njëjti sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.073/2022, të datës 13.10.2022, është emëruar dhe rrjedhimisht ushtron pozitën Asistent Administrativ në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Tutje, nga provave materiale të kësaj çështje del se ankuesi me datë 23.05.2025, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagës jubilarë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore, ndërsa, ky i fundit më Vendimin më numër protokolli 223, të datës 05.06.2025, ka aprovuar kërkesën e ankuesit të datës 23.05.2025, duke i njohur të drejtën e kompensimit për pagë jubilarë rrjedhimisht për 20 vite përvojë pune dhe atë në vlerën e përgjithshme financiare prej 363.00 Euro. Sipas thënieve në ankesë, ankuesi asnjëherë nuk ka pranuar këtë kompensim, ndërsa, SHKK në përgjigje në ankesë nuk ka dhënë asnjë sqarim që arsyeton mos ekzekutimin e kompensimit për shpërblimin e dytë jubile të aprovuar nga organi i punësimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon së nuk ka realizuar të drejtën e njohur sipas Vendimit më numër protokolli 223 të datës 05.06.2025. Kërkon që Këshilli ta detyroj SHKK-në që të ekzekutoj kërkesën e aprovuar më Vendimin më numër protokolli 223 të datës 05.06.2025.

Në kuptim të statusit ligjor të të punësuarve në Shërbimin Korrektues, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 6, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët ku përcaktohet: “1. *Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues.... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. ..*” si dhe nenit 4 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik, në fuqi nga data 17.06.2025, e më të cilin parashihet se : 4 1. *Në paragrafin 2. të nenit 3 të ligjit bazik pas nën-paragrafit 2.9. shtohen nën-paragrafët si në vijim:....2.18. zyrtarët korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës.. 6.1. Neni 6 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim: Neni 6 Nëpunësi civil me status të veçantë 1. Nëpunësi civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunësit civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarit e Shërbimit Korrektues të Kosovës, **përfshijmish zyrtarët korrektues**”,*

Referuar nenit 3 nënpika 1.17 të Ligjit NR. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Zyrtar Korrektues konsiderohet personeli i uniformuar dhe i graduar, ndërsa, me nenin 28 dhe 53 të këtij ligji është përcaktuar se: *Neni 28. Personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës 1. Personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës e përbëjnë: 1.1. nëpunësit civil; 1.2. **zyrtarët korrektues profesional të armatosur në uniformë dhe grada të rregulluara me këtë Ligj**; 1.3. stafi mbështetës përbëhet nga stafi teknik dhe administrativ të cilët kryejnë veprimtari ndihmëse. 2. Personeli i SHKK sipas paragrafit 1. të këtij neni janë nëpunës civil dhe nëpunës të uniformuar të sigurisë, sipas këtij ligji dhe ligjit për zyrtarët publikë. 3. Personeli i Shërbimit Korrektues sipas paragrafit 1. të këtij neni janë nëpunës civil me status të veçantë sipas ligjit për zyrtarët publikë. Neni 53. Sistemi i Gradave 1. Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat vijuese: 1.1. kadet për zyrtar korrektues; 1.2. zyrtar korrektues; 1.3. mbikëqyrës; 1.4. mbikëqyrës i Lartë; 1.5. udhëheqës i Njesisë.*

Bazuar në kuadrin ligjor si më sipër Kolegji thekson së të punësuarit në SHKK përfshijmish zyrtarëve korrektues (personeli i uniformuar dhe i graduar) kanë statusin e nëpunësit civilë me status të veçantë, kështu që, mbi këtë bazë pozita e ankuesit si asistent administrativ kategorizohet si pozitë e nëpunësit civil, andaj, edhe Këshilli ka juridiksion ligjor që të trajtoj dhe të vendos lidhur me çështjen e iniciuar sipas ankesës A.nr.1647/2025.

Rrjedhimisht, duke qenë së e drejta e ankuesit në pagë jubilar për 20 vite përvojë punë ka lind më datë 06.05.2022, fakt ky i konfirmuar më Vendimin më numër protokolli 223, të datës 05.06.2025, të Menaxheri të Personelit të SHKK-së, rezulton së në këtë periudhë ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili me nenin 22, paragrafi 2 ka paraparë: *Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: 2.1. pagesën për rastet kur janë tepricë nga puna; 2.2. pagesën për shkak të pensionimit; 2.3. **shpërblimi i përvjetorit (jubile),** ndërsa, Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera, më nenin 21 përcaktonte: *Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune.**

Andaj, mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji erdhi në përfundimin së Njësia e Personelit të SHKK-së më të drejtë i ka njohura ankuesit të drejtën e shpërblimit të dytë jubile dhe së në rastin konkret kërkesa e ankuesit për kompensim të shpërblimit jubile e parashtruar më datë 23.05.2025, është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar më nenin 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës u vendosi si në dispozitiv të këtij, vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1647/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,A.T;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.